Fletë pune në auditor · Ora I dhe Ora II

Prof. As. Dr. Siditë Duraj
Viti akademik 2026–2027

Emri, mbiemri: _____ Data: _____

PARASHIKIM · INDIVIDUALISHT · 4 MINUTA

Dy mësues, dy korrigjime

MËSUESI I PARË

«5 − 8 nuk bëhet.»

MËSUESJA E DYTË

8 + 4 = 12 + 5 = 17 ✓

1. Çfarë është e saktë dhe çfarë mungon në secilin korrigjim?

2. Çfarë mund të ndërtojë nxënësi nga këto fjali në vitet që vijnë?

ORA I · PUNA NË ÇIFTE

Rregullat e zbritjes: kushti dhe kundërshembulli

Rregulli në $\mathbb{N}_0$	Kushti	Kundërshembull kur kushti mungon
$(a - b) - c = a - (b + c)$		
$a - (b - c) = (a - b) + c$		
$(a + b) - c = (a - c) + b$		

3. Genti shkruan $43 - 19 = 43 - 20 - 1 = 22$. Shkruani dy hipoteza dhe një pyetje që i dallon.

Ora II · ekuacionet dhe rendi i veprimeve

Prof. As. Dr. Siditë Duraj
Individualisht dhe në çifte

Emri, mbiemri: _____ Data: _____

GJASHTË TRAJTAT

Zgjidhni dhe emërtoni lidhjen që përdorni

Ekuacioni	x =	Lidhja ndërmjet përbërësve
$x + 9 = 23$		
$x - 9 = 14$		
$23 - x = 9$		
$6 \times x = 42$		
$x : 6 = 7$		
$42 : x = 7$		

4. Te cilat dy trajta gabon rregulli «të panjohurin e gjejmë me veprimin e kundërt»? Pse?

RENDI I VEPRIMEVE

5. Llogaritni: $20 - 4 \times 3 + 2$ = _____ $24 : 4 \times 2$ = _____ $10 - 3 + 2$ = _____

6. Liri shkruan $2 + 3 \times 4 = 20$. Hartoni dy shprehje: njëra që e dallon leximin nga e majta dhe një që nuk e dallon.

✂ Bileta e Orës I

7. Shpjegoni $72 - 38 = 72 - 40 + 2$ me pohimin 3.3. Cili rregull dhe me çfarë kushti?

8. Riformuloni për klasën e dytë: «Numri i vogël nuk zbritet nga i madhi.»

Ora III dhe Ora IV · relacionet


Prof. As. Dr. Siditë Duraj
Individualisht dhe në çifte

Emri, mbiemri: Data:

ORA III · NGA TABELA TE DIAGRAMI

Në A = {1, 2, 3, 4}: «x dhe y kanë të njëjtën mbetje me 2»

R	1	2	3	4
1				
2				
3				
4				



9. Shënoni çiftet në tabelë dhe vizatoni diagramin e shigjetave. Cilat veti ka relacioni? Për çdo «jo», një kundërshembull.

Refleksiv	Simetrik	Antisimetrik	Kalimtar	Klasat, nëse është ekuivalencë

10. Në {1, 2}, a është relacioni {(1, 1)} simetrik? Kalimtar? Refleksiv? Çfarë tregon ky shembull?

✂ Bileta e daljes · Ora IV · 4 minuta

11. Në {1, 2, 3} jepet $R = \{(1, 1), (2, 2), (3, 3), (1, 2), (2, 3)\}$. Cilat nga katër vetitë ka? Për çdo «jo», një kundërshembull.

12. Një nxënës shkruan $6 + 5 = \square + 4$, $\square = 11$. Formuloni një hipotezë dhe një pyetje që e provon.

13. Pse ndarja e numrave 1–12 në «çift» dhe «më të mëdhenj se 6» nuk është ndarje?